



Financuar nga Bashkimi Evropian

Bashkëfinancuar nga Agjensia  
Ndërkombëtare Suedeze për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim



Sweden  
Sverige

## Vlerësimi përfundimtar për projektin

### Lufta kundër Diskriminimit, Përmirësimi i të Drejtave të Punës së Grave

#### Hyrja dhe metodologjia

Vlerësimi përfundimtar analizon rezultatet e arritura të projektit si edhe jep disa rekomandime për zbatim për Koalicionin Rajonal kundër Diskriminimit me bazë Gjinore, për të adresuar diskriminimin me bazë gjinore (DBGJ) dhe për të çuar më tej të drejtat e punës së grave në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Vlerësimi u realizua duke mbajtur në fokus nevojshmërinë dhe pjesëmarrjen e aktorëve përkatës. Të dhënat sasore dhe cilësore u grumbulluan përmes rishikimit të dokumentacionit të disponueshëm të projektit, intervistave të aktorëve kryesorë, pyetësorëve të vetë-vlerësimit dhe një sondazhi online që përfshiu palët kryesore të përfshira në projekt si: Organizatat Partnere Zbatuese të Projektit, (PZ) dhe Organizatat Përfutuese të mbështetura financiarisht nga skema e dhënies së Granteve (PG). Në total, janë konsultuar 33 përfaqësues (29 gra, 4 burra) të PZ-ve dhe PG-ve, aktorëve qeveritarë dhe jo-qeveritare bashkëpunëtorë në projekt, me synim analizën e opinioneve, perspektivës dhe përvojës së tyre në projekt.

#### Konkluzionet kryesore

Në tërësi, projekti vlerësohet shumë i nevojshëm dhe i rëndësishëm, i zbatuar me sukses dhe me një nivel të lartë efektiviteti dhe efikasiteti. Projekti konsiderohet shumë i rëndësishëm për grupet/OSHC-të për të drejtat e grave, për shkak të ndikimit të tij në rritjen e kapaciteteve të tyre në drejtim të zbatimit të legjislacionit kundër diskriminimit, analizën, monitorimin e DBGJ në punë dhe të drejtat e punës, advokimin, angazhimin e qytetarëve dhe bashkëpunimin në rajon. Projekti ka ndikuar drejtpërdrejtë në mënyrë pozitive në përvojën e organizatave, duke mbështetur bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave në rajon. PZ, PG, OSHC të tjera dhe institucionet publike të përfshirë në projekt kanë demonstruar përkushtim në luftën për të drejtat e grave, kundër diskriminimit në punë. **17** ndryshime janë evidentuar si rezultat i nismave advokuese të OSHC të lidhura me dokumente ligjore dhe politike. **199** raste kundër diskriminimit janë referuar në institucionet përkatëse dhe janë monitoruar për adresimin dhe zgjidhjen e duhur të tyre. **183** OSHC të ndryshme janë angazhuar në iniciativa advokimi, procese vendim-marrëse dhe reforma në lidhje me të drejtat e punës së grave. **30** amendamente ligjore dhe të politikave në lidhje me sigurimin e barazisë gjinore janë paraqitur për miratim pranë strukturave përkatëse. **23** iniciativa janë ndërmarrë nga institucionet përkatëse (p.sh. Mekanizmat Kombëtarë të Barazisë Gjinore, Avokati i Popullit, Inspektorati i Punës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi) në mbështetje të përpjekjeve të OSHC-ve për të mundësuar zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit. Janë publikuar **14** raporte studimore (shtatë studime fillestare në 2019, dhe shtatë studime përfundimtare në 2022), duke përfshirë dy raporte në secilin vend dhe dy raporte rajonale. Këto raporte analitike janë të parat e këtij lloji të realizuara në fushën e DBGJ në Ballkanin Perëndimor (BP). Mediat vendase në BP kanë pasqyruar **558** herë çështje të lidhura me diskriminimin ndaj grave në punë. **299** takime ndërjegjësuëse janë realizuar me sukses për të përmirësuar të kuptuarit e DBGJ.

**Rëndësia/Relevanca:** Projekti është hartuar dhe zbatuar në përgjigje të nevojave dhe prioriteteve të grupeve të synuara, aktorëve kryesorë të përfshirë në projekt si edhe përfutuesve vendas në kontekstet përkatëse.

**Efektiviteti:** Projekti ka realizuar plotësisht nivelin e rezultateve të synuara dhe nuk ka diferencë midis rezultateve në grupet e synuara. Koalicioni i ka tejkaluar objektivat e tij në shumicën e treguesve

Zbatuar nga:



Gender Alliance for Development Center  
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



KVINNA  
KVINNA

REACH-OR  
research in action



WOMEN'S RIGHTS CENTER  
CENTAR ZA ŽENSKA PRAVA

të paracaktuar në projekt. Partnerët kanë krijuar marrëdhënie shumë efektive bashkëpunimi me institucionet përkatëse në çdo vend të BP. Rrjeti i grave të Kosovës (KWN) në cilësinë e partnerit koordinues në projekt realizoi në mënyrë shumë efektive skemën e dhënies së granteve duke mbështetur financiarisht projektet e 14 OSHC-ve të ndryshme lokale në BP. Planifikimi më i mirë i burimeve njerëzore, partneritetet e zgjeruara me sektorin e biznesit dhe sindikatat, analiza e thellë dhe ndjekja e strategjive të advokimit në nivel kombëtar dhe përfshirja e më shumë grave përfituese në nismat e advokimit në nivel kombëtar dhe rajonal u identifikuan ndër faktorët kryesorë, në kontroll të partnerëve respektivë që mund të kishin kontribuar në një proces advokimi më efikas përgjatë zbatimit të projektit.

**Efikasiteti:** Projekti vlerësohet shumë efikas dhe ka përdorur të gjitha burimet (njerëzore dhe financiare) në mënyrën e duhur. PZ i janë përgjigjur menjëherë dhe në mënyrën e duhur situatave të paparashikuara si p.sh Covid-19 duke bashkëvepruar me sukses midis tyre dhe me OSHC të tjera, institucionet publike dhe aktorët ndërkombëtarë. Disa nga komponentët kryesorë që e përforcojnë efikasitetin dhe konkurrueshmërinë e këtij projekti me projekte të tjera janë: dimensionin e tij rajonal, kohëzgjatja, përfshirja e gjerë të shumë OSHC-ve, institucioneve publike dhe jo publike, advokimi me evidenca dhe raste konkrete, si edhe faktit që ky projekt ka adresuar për herë të parë DBGJ në nivel vendor dhe rajonal nëpërmjet informimit, nismave advokuese dhe platformave të diskutimit në Bruksel dhe delegacionet e BE-së në vendet e BP.

**Impakti/Ndikimi:** Ndryshimet politike dhe ligjore të mbështetura nga projekti kanë një ndikim afatgjatë dhe të qëndrueshëm në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punës së grave. Projekti mundësoi realizimin e proceseve gjyqësore me fokus në çështjet e DBGJ në punë (për herë të parë në disa vende të BP) të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në vendosjen e praktikave gjyqësore. Projekti ndikoi në mënyrë shumë pozitive dhe të dukshme në ndërveprimin dhe bashkëpunimin rajonal me një ndikim të gjerë ndaj krijimit të grupeve dhe praktikave bashkëpunuese efektive, si dhe transferimit të njohurive nga projektet e mëparshme, aktuale dhe të ardhshme të financuara nga Bashkimi Evropian (BE) dhe donatorë të tjerë. Projekti ndikoi drejtpërdrejt në krijimin e evidencave me të dhëna përkatëse për DBGJ në punë.

**Qëndrueshmëria:** Projekti ka prodhuar rezultate të qëndrueshme në nivele të ndryshme: (i) Advokimi rajonal, (ii) Politika kombëtare, (iii) Zhvillimi organizativ dhe i qëndrueshëm i PZ-ve dhe PG-ve, dhe (iv) Përfituesit e drejtpërdrejtë nga komuniteti. Rezultatet e projektit në këto nivele kanë shkallë të ndryshme të qëndrueshmërisë. Rezultatet e arritura në nivelet e advokimit rajonal, politikës kombëtare dhe zhvillimit organizativ të PZ, PG-ve kanë gjasa të larta për tu ruajtur dhe përmirësuar në vazhdimësi. Ndërkohë, qëndrueshmëria e punës së PZ dhe PG-ve në nivel kombëtar dhe ofrimi i shërbimeve të drejtpërdrejta për përfituesit mbeten ende faktorë kritikë dhe sfidues për shkak të varësisë nga financimi i donatorëve dhe financimit të pamjaftueshëm publik në nivel qendror dhe vendor i cili është në nivele të ndryshme në vendet e BP.

**Koherenca:** Projekti konsiderohet *i veçantë* pasi shumë pak (thua se aspak) iniciativa të ngjashme kanë ekzistuar në trajtimin e DBGJ në punë. Qasja rajonale e kombinuar me atë sektoriale, të lidhura drejtpërdrejt me procesin e anëtarësimit në BE të vendeve të BP, është identifikuar si vlerë e shtuar e BE-së, në mbështetje të advokimit të OSHC-ve në këtë proces.

**Të tjera:** Njohja dhe kuptimi i DBGJ, të drejtave dhe praktikave të barazisë gjinore, ngacmimit seksual në punë janë promovuar gjerësisht përmes aktiviteteve të projektit. Kufizimet e Covid-19, patën një ndikim pozitiv në mbrojtjen e mjedisit për shkak të reduktimit të përdorimit të transportit. Projekti aplikoi përgjatë kohës së zbatimit të tij një qasje gjithëpërfshirëse të bazuar në të *Drejtat e njeriut* dhe metodologjinë *Askush të mos mbetet pas*.

## Rekomandime kryesore

---

- Realizim të konsultimeve nga një *qasje feministe* me pjesëmarrje të përfituesve të drejtpërdrejtë në hartimin e projekteve të ardhshme (Koalicioni).
- Mbështetje e vazhdueshme për OSHC-të, për të rritur më tej ndërgjegjësimin në lidhje me të drejtat e punës dhe DBGJ, mbajtjen e DBGJ në vëmendje të qeverive përkatëse në BP (BE dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim, Sida).

- Mbështetje të mëtejshme për OSHC-të, në zhvillimin e kapaciteteve për të mbështetur gratë viktimat të DBGJ në punë, për të ofruar ndihmë juridike dhe për të bashkëpunuar me gjykatat në monitorimin e rasteve dhe advokimin në të gjitha nivelet (Koalicioni).
- Mbështetje e vazhdueshme për koalicionet që mbështesin drejtpërdrejtë OSHC-të që u shërbejnë në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme grupeve në nevojë. Mbështetja e OSHC-ve me përvojë dhe të kualifikuara nëpërmjet skemës së dhënies së granteve është e rëndësishme për të mundësuar që OSHC-të që bëjnë përpjekje, të aplikojnë drejtpërdrejtë dhe të përfitojnë nga fondet e BE-së në të ardhmen (BE).
- Mbështetje e vazhdueshme në ndërtimin e kapaciteteve të OSHC-ve përmes granteve/thirrjeve të ngjashme. Rekomandohen projekte afatgjata për skemën e dhënies së granteve dhe më shumë financime në dispozicion, të cilat do të mundësojnë OSHC-të vendase të japin rezultate më të mira, më të qëndrueshme dhe afatgjatë (Koalicioni, BE dhe Sida).
- Nxitja e mëtejshme e advokimit të vazhdueshëm ndërveprues, bazuar në fakte dhe të dhëna konkrete për të mundësuar ndryshime dhe përmirësime të kuadrit ligjor drejt harmonizimit të qëndrueshëm të ligjeve kombëtare me acquis të BE-së për Barazinë Gjinore (Koalicioni).
- Praktikant më të mira, njohuritë e fituara dhe metodat kërkimore duhet të promovohen, zhvillohen më tej dhe të zbatohen në programe dhe projekte në të ardhmen (Koalicioni).

*Ky dokument është përgatitur nga Ekipi vlerësues i përbërë nga Mirela Jonuzaj (Drejtuese e Ekipit), Edlira Ngjerci Shima dhe Maida Cehajic-Campara. Ky produkt jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet dhe opinionet e KWN ose partnerëve të saj dhe as të Komisionit Evropian apo Agjencisë Suedeze Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Bashkëpunim, të cilët kanë financuar këtë vlerësim.*